



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:090072
Datë: 12.01.2024
Numri i dokumentit: 05184614

C-III-15-0696

Paditësi: M P nga L, Prizren, i përfaqësuar nga A J nga fshati C, Rahovecë.

Kundër

Të Paditurit: NSH “Progres”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. Driton Hoxha nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimi, Kolegji i Specializuar i përbërë me gjyqtarin kryesues Hasim Sogojeva, dhe gjyqtaret Agron Hoxhaj dhe Diellza Hoxha me 12 janar 2024, mori këtë:

:

A K T V E N D I M

Ankesa e paditësit M P konsiderohet e tërhequr.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 21 tetor 2015, pranë DHPGJS, është pranuar nga paditësi kërkesë/padia, me të cilin ka kërkuar njohjen e së drejtës pronësore mbi ngastrën kadastrale të regjistruar me nr. P-..., me sipërfaqe 8.47 ha. Të cilën pretendon se ia kanë konfiskuar me reformat agrare.

Me 08.12.2021, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, paditësit i ka leshura urdhrin C-III-15-0696 me të cilin ka kërkuar brenda 10 dite të plotësojnë ankesën/padinë e ushtruar, ashtu që të tregojnë bazën juridike të kërkesëpadisë, faktet në të cilat mbështet pretendimet dhe provat që vërtetojnë faktet. Gjykata paditësin e njoftoj se nuk mund të përfaqësohet nga një preson që nuk është avokati i licencuar nga Oda e Avokatëve, kështu që të angazhoj avokat.

Po ashtu ka kërkuar paditësit të paguaj taksën gjyqësore në afatin prej 15 ditëve. Me të cilën është njoftuar edhe për pasojën juridike të mos pagesës së taksës.

Më dt. 05.01.2022, Urdhri përmes Postes ju është dorëzuar të autorizuarit të paditësit A J. Ndërsa në adresën e paditësit dërgesa përmes postës ka qenë e pa suksesshme.

DHPGJS, pas dështimit të dorëzimit të urdhrimit për taksë, bazuar në dispozitën e nenit 26.5 të Shtojcës së LDHP dhe nenit 116.5, lidhur me nenin 116.6 të LPK-së, ka vendosur me Urdhër C-III-15-0696, dt. 24.03.2022, paditësit ti publikohet në tabelë të shpalljeve Urdheri për taks gjyqësore.

Arsyetimi ligjor

Ankesa/Padia e paditësit, konsiderohet e tërhequr.

Paditësi nuk e ka paguar taksen gjyqësore .

Bazuar në nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, hyrë në fuqi më 01 maj 2017, për aplikimin e njëjtë të taksave gjyqësore, paditësit i kërkohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga të shërbyerit dhe pranimit i urdhrimit të gjykatës për të ia dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetimin dhe faturën e pagesës të shumës së caktuar që duhet paguar ose që t'i dorëzojë gjykatës prova në lidhje me faktin se ai është i liruar nga pagesa për arsye se është përfitues i ndihmës sociale nga ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Ndihmës Ligjore nga Zyra për Ndihmë Juridike.

Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 paragrafi 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore për procedimin në shumën e duhur, ashtu që sipas neni 13 të Udhëzimit Administrativë nr. 01/2017, për unifikimin e taksave gjyqësore është caktuar taksa në lartësi 100 €.

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017, neni 5.5.2 parasheh që, "nëse pas njoftimit, pala nuk i paguan taksat gjyqësore, sipas nenit 5.1 të këtij udhëzimi, gjyqtari i caktuar për çështjen, do të aplikojë nenin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr.

Paditësi përmes urdherit për pagesën e taksave gjyqësore e publikuar në tabelë të shpalljeve më dt. 28.03.2022, u informua për faktin se në bazë të nenit të lartpërmendur të Udhëzimit Administrativ, në rast të mos pagesës, ose rast të mos paraqitjes në gjykatë, brenda afatit të caktuar prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, Gjykata do të marrë një vendim duke e konsideruar çështjen në fjalë si të tërhequr.

Meqenëse paditësi, nga dita e publikimit të vërejtjes për taksë dt. 28.03.2022, deri në ditën e marrjes së vendimit nuk e ka dorëzuar dëshminë për pagesën e taksës gjyqësore, në kuptim të dispozitës së nenit 253. 5 të LPK-së, gjykata kërkesën / ankesën e paditësit e konsideroi të tërhequr.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar kryesues

Agron Hoxhaj, Gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtare